



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Nr. 2700 prot.

Elbasan, më 06.12.2021

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurës së aplikimit për kandidatë në Bordin e Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Bazuar në nenin 48 të Ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", anëtarët e Bordit të Administrimit, përfaqësues të UE-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i UE-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga UE.

Në kushtet e mbarimit të mandatit pesëvjeçar të 3 anëtarëve përfaqësues të UE-së njoftojmë fillimin e procedurës së aplikimit për kandidat në Bordin e Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Lista e kandidatëve së bashku me të dhënat e tyre, do t'i paraqiten Senatit Akademik.

Dokumentacioni i nevojshëm për kandidim:

1. Formular aplikimi për anëtar të Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
3. Curriculum Vitae.
4. Fotokopje e Titullit akademik / Gradës shkencore, marrë /njohur me Vendim të Komisionit përkatës.
5. Vërtetim i vendit të punës.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e sipërpërmendur brenda datës 16.12.2021, ora 14.00, pranë sekretarisë së Senatit Akademik në Rektorat.



REKTORI

Prof.Dr. Skender TOPI